

FJALA E DEPUTETIT ENKELEJD ALIBEAJ

E ENJTE 17 NËNTOR 2022

Pikë së pari, doja të sqaroja diçka për të gjithë ata që na ndjekin. Ky është një mocion dhe parlamenti shqiptar do të diskutojë për një çështje shumë të rëndësishme, siç është progresraporti i BE-së për Shqipërinë, për të diskutuar rrugën që Shqipëria do të duhet të marrë dhe ta çojë përpara, orientuar drejt Brukselit. E kam kërkuar unë, Enkelejd Alibeaj.

Së pari, do të doja të thosha diçka për të gjithë ata që më përmendën emrin, por edukata familjare nuk ma lejon t'ua përmend emrin dhe të flas me të njëjtën gjuhë. Flas me qetësi, se, kush e do opozitën, se kush bën opozitë reale, mund të bëjë vetëm diçka: të shkëputet nga gjuha e shëmtuar e 30 vjetëve, që ka mbizotëruar në këtë parlament. Ky është pazari i vërtetë. Janë një pjesë deputetësh këtu, që ngrihet ai para një jave e lëshon rrëke psikike me sharje e fyerje dhe pasohet nga një iso nga një pjesë tjetër këtu; është e njëjta gjuhë, janë të njëjtat fyerje, të njëjtat epitete. Akuzohemi ne për shitje, akuzohemi ne për pazare?! Jo! Shqiptarët duhet ta kuptojnë sot e përgjithmonë se ka ardhur koha për t'u ndarë nga ky 30-vjeçar që ka mbajtur të mbyllur, të mbytur, të asfiksuar këtë vend dhe shqiptarët. Kjo është një lojë hipokrite 30- vjeçare, hidh e prit. Ky është fundi. Përfundimisht, ky është fundi.

Kjo është ndarje; është ndarje në gjuhë, në mentalitet, në sinqeritet; hedhje përtej hipokrizisë opozitare. Jo, jo opozita bëhet e ndjerë; opozita nuk bëhet hipokrite; opozitë nuk është të vish dhe të bësh zhurmë, pastaj jashtë kësaj seance të ndash oligarkë, klientë dhe afera. Jo, jo e vërteta u duhet thënë shqiptarëve, të paktën ne këtu e kemi për detyrim me çfarëdolloj kostoje. Është një detyrim historik ndaj zgjedhësve tanë, ndaj shqiptarëve, ndaj të ardhmes së këtij vendi. E kemi për detyrë ta bëjmë sot dhe do ta bëjmë në vazhdim. E di që dara e 30 vjetëve do të vazhdojë. Ne duhet të jemi të bindur. Kjo është sakrificë që na kërkohet; ky është momenti historik që duhet ta marrim përsipër. Do të dëgjojmë sharje, baltëra: “të shitur, të blerë, pazarxinj”. Ou, pazarxinj ne?!

Pazarxinj ne, kur komisionin për inceneratorët një pjesë këtu nuk e votuan me bisht në shalë, por sot na e mbajnë si kauzën më të madhe?! Është sakrificë, është kontribut i disa njerëzve këtu, që sot mund të jenë edhe të fshehur, mund të jenë edhe të heshtur, që kanë fisnikërinë për të gjithë këtë kontribut, këtë sakrificë, sepse është sakrificë e madhe t'u dalësh përballë 30 vjetëve të pazareve të fëlliqura, të cilat e mbajnë këtë vend vendnumëro, 32 vjet. Vazhdojmë akoma ne sot: “E duam Shqipërinë si e gjithë

Europa". Jemi në fund. Pse jemi në fund? Pse jemi ende me mendimin e vagët të para 32 vjetëve, me ëndrrën e vvarë të shqiptarëve? Ja, pra, kjo që ndodh këtu: njëra anë me anën tjetër, zhurmë! Në fakt, ne jemi këtu për t'ua bërë të ditur me përlësi, shqiptarëve se si është e vërteta, pa bërë pazare.

Kush bën pazare, ai që denoncon, ai që bën opozitë? Kush bën pazare, ai që voton kundër hapjes së dosjeve të komunizmit? Ai bëka pazare?! Kush bën pazare? Ai që nuk do që të votohet lustracioni? Kush bën pazare, ai që denoncon portin e Durrësit, ndërkohë që një pjesë e madhe këtu, nga të dyja palët, janë të zhytura deri këtu? E di që kërkua josh. E di që duhet guxim i madh. Këtë do të bëjmë ne të gjithë. E kemi mbajtur kaq kohë thellë edhe në stomak, po të doni, për shkak të fisnikërisë, që ajo ndarja e madhe, që po ndodh mes nesh, të mos përcillet atje të njerëzisë, në fakt, njerëzisë poshtë janë të qartë prej shumë kohësh se çfarë ka ndodhur mes nesh. Gjithmonë e kanë pasur këtë brengë, tani ka dalë, dhe duhej të kishte dalë kohë më parë.

Pra, edukata familjare nuk më lejon të përgjigjem me të njëjtën gjuhë, por të vërtetën duhet ta themi. Duhet ta themi troç, ashtu siç është. Këtë mocion e kam kërkuar unë, kryetar i Grupit Parlamentar të PD-së, përfaqësues i këtyre burrave, një pjesë e burrave dhe grave dinjitoze, që nuk kanë asgjë që i lidh me 30 vjetët e shkuara. E kam thënë më përpara që nuk kanë skelete në dollapë, që nuk i kanë këmbët e lidhura, që nuk kanë ambicie për të bërë plaçkë me politikën. Sigurisht, e kanë për nder për t'ju përfaqësuar, aq sa mund t'ju përfaqësojnë, sepse secili prej jush përfaqëson familjen, emrin, qytetarinë, ndershmërinë. Nuk përfaqësoj askënd dhe nuk dua të përfaqësoj asnjë, me të cilin nuk më lidh asgjë; asgjë nuk më lidh, sepse e vërteta do të na bëjë të lirë, duke e thënë kështu, siç është.

Kjo do të jetë përgjigjja ime sa herë që në këtë parlament vihet dhe bëhet zhurmë; bëhet zhurmë gjatë sikur ka një përplasje të madhe me këtë palën këtej. E dimë fare mirë lojën që ju, këtej, bëni. Kjo ju intereson juve, zhurma, asgjë e thënë hapur që të shkojë te veshi i njerëzve. Jo, të zhytur në të gjitha aferat tuaja, ju intereson vetëm kjo gjë: të keni shëmbëlltyrën tuaj nga ana tjetër dhe, sigurisht, shqiptarët e mendojnë këtë. Por këta, si njëra palë dhe pala tjetër, kështu janë. Jo, jo nuk janë kështu. Ka një pjesë që mendon ndryshe, është një pjesë e shoqërisë, e cila do një orë e më parë shkëputjen nga ky tranzicion banal 30-vjeçar. Ne po bëjmë aq sa mundemi dhe do ta bëjmë deri në fund. Fjalën kemi, persistencën kemi, shqiptarët janë ata që do të na gjykojnë.

Do të vazhdoj tani prezantimin e mocionit të paraqitur nga unë, Enkelejd Alibeaj, që kam nderin ta ndaj së bashku me disa nga kolegët e mi. Për sa i përket kohës për të folur për këtë mocion, më lejoni me shumë përlësi të them se kushdo, i cili mund të ndihet i kufizuar në fjalën e tij, ka të drejtën, sipas

Rregullores, me 7 anëtarë të nënshkruar, të kërkojë një tjetër mocion, një tjetër mocion, një tjetër mocion. Parazitë në opozitë nuk pranojmë. E kemi kërkuar ne dhe do ta çojmë në fund sipas mendësisë, mentalitetit dhe vlerave tona. Këtë do të bëjmë. Meqë ra fjala, këtë mocion drejtuesi i seancës ka një muaj që e ka paraqitur; një muaj, sapo doli raporti i BE-së; një muaj e mbajtët në sirtar dhe askush këtu, që bën zhurmë e qahet, as që u kujtua fare, vetëm sot u ra ndër mend.

E, pra, 32 vjet më parë pak kush mund ta kishte menduar që akoma dhe sot Shqipëria nuk do të ishte një vend anëtar me të drejta të plota në BE. Vitet kanë kaluar, fëmijët e asaj kohe janë burrëruar, të rinjtë e asaj kohe kanë kaluar të 50-at, gratë dhe burrat e asaj kohe kanë dalë në pension, por Shqipëria ende nuk është vend i BE-së. Nuk është vend i BE-së, madje më keq akoma, në këta 9 vjet, që qeverisin këta, është shumë larg ajo ditë e shumëpritur nga të gjithë shqiptarët e asaj kohe. Në vendin, shtetin e së drejtës, të të drejtave të njeriut, që e filloi rrugëtimin drejt demokracisë me thirrjen: “E duam Shqipërinë si e gjithë Europa”, duket se edhe shumë breza të tjerë do të kalojnë, përpara se sa kjo ëndërr të bëhet realitet. Sot nuk jam për të bërë analizën e 32 vjetëve.

Nuk dua të mbetem peng i këtyre 32 vjetëve, që janë mbushur plot me gabime, këndeje dhe andej. Kam guxim të shikoj të vërtetën ashtu siç është në fakt, por ka edhe një arsye: në 9 vjet që qeverisni ju, Shqipëria ka mbetur vendnumëro në atë vend. Besoj se i kujtoni deklaratat plot solemnitet të Edi Ramës për hapjen e negociatave, madje absurdi shkoi deri atje sa në qershor të vitit 2018, përveçse hapët shishet e shampanjës, dekoruat edhe 4 ambasadorë për hapjen e negociatave. 4 ambasadorë dekoruat në vitin 2018 për t’u shitur shqiptarëve se negociatat u hapën! Në fakt, u hapën vetëm tani, në 2022-shin. U hapën, por a është kuptuar siç duhet ky vendim bujar i Perëndimit, i Europës? A ndihet ky vendim, ashtu siç duhet? Është shumë e vështirë ta thuash. Hapja e negociatave nënkuptonte, sigurisht, avancim në rrugën drejt BE-së; më shumë detyra për Shqipërinë, në radhë të parë, për qeverinë shqiptare.

Fatkeqësisht, kjo e fundit, qeveria ka treguar një mendësi totalisht të gabuar lidhur me këtë proces. Sa herë që ka dështuar të bëjë hapa përpara, është përpjekur ta gjejë fajin tek të tjerët, ndonjë vend anëtar i BE-së, i cili, sipas Edi Ramës, nuk e dashka Shqipërinë anëtare të familjes evropiane! Edhe kur parlamenti shqiptar u mbush me të inkriminuar; edhe kur Shqipëria u mbulua nga droga; edhe kur Shqipëria provoi vjedhjen e votës; edhe kur Shqipëria u rendit më lart se vendet e tjera në luftën për numrin e emigrantëve, si edhe tani; edhe kur Shqipëria ishte krahas vendeve afrikane për nivelin e lartë të korrupsionit; edhe kur Departamenti Amerikan i Shtetit thoshte se korrupsioni është përhapur në të gjitha nivelet e qeverisjes; edhe kur Shqipëria doli në përgjimet italiane si lavatriçja e pastrimit të parave

në ndërtim; edhe kur u zbulua megaafera korruptive e incenatarorëve, dhe shembujt mund të vazhdojnë me radhë, faji në këto raste nuk ishte i qeverisë, nuk ishte i Edi Ramës, nuk ishte i maxhorancës, ishte i vendeve anëtare të BE-së që nuk ua donin të mirën Shqipërisë dhe shqiptarëve.

Do të ndalem edhe në disa sinjale të tjera negative që ka prodhuar qeveria shqiptare për Brukselin, por do të kthehem tek arsyeja pse e kam kërkuar zhvillimin e këtij mocioni me debat. Muajin e kaluar Komisioni European publikoi progresraportin për vitin 2021. Ky dokument është i një rëndësie thelbësore për procesin e integritimit evropian; është thujse një manual pune për institucionet shqiptare, me konstatime, me problematika, detyra dhe objektiva të përditshëm, të përmuajshëm dhe të përvitshëm. Nëse qeveria nuk e trajton të tillë, pa dyshim që procesi do të vazhdojë të mbetet në stanjacion dhe vitin tjetër përsëri do të gjendet armiku te BE-ja. Ndaj, sot kemi kërkuar këtë mocion pikërisht me synimin që të tregojmë të vërtetën dhe shqiptarët të kuptojnë, që të jenë të përgatitur vitin tjetër, kur të dëgjojnë përsëri qeverinë dhe Edi Ramën që ta gjejnë fajin tek të tjerët.

Progresraporti i BE-së dëshmoi se shqetësimet dhe problematikat e ngritura nga Grupi Parlamentar i PD-së kanë qenë reale dhe të drejta, ndryshe sa thotë Kryeministri se “opozita e rublave”, shprehja e tij e preferuar e këtyre ditëve, dëshiron të dëmtojë imazhin e Shqipërisë lule. Progresraporti provoi edhe njëherë se problemet ekzistojnë, madje disa prej tyre janë përkeqësuar, falë dorës së qeverisë “Rama”. Secili prej kolegëve të kësaj ane të parlamentit do të flasë në mënyrë të detajuar për problemet e ngritura sipas fushave dhe komisioneve që mbulojnë, por unë do të ndalem, se nuk bëj dot ndryshe, në disa prej më të rëndësishmeve, duke filluar nga fenomeni i shitblerjes së votës, përdorimi i aseteve publike dhe patronazhistëve. Ashtu si edhe raporti përfundimtar i OSBE/ODIHR-it, Komisioni European konfirmoi se në zgjedhjet parlamentare të 25 prillit fenomeni i blerjes së votës ishte i përhapur pasivisht.

Kryeministri, ministrat, zyrtarë të tjerë përdorën funksionin publik për të krijuar avantazh elektoral dhe të dhënat personale dhe sensitive të qytetarëve u vodhën nga skema e patronazhistëve, e ndërtuar kjo nga partia në pushtet, të cilën qytetarët shqiptarë e dëgjojnë që betohet dhe përbetohet se edhe tani për zgjedhjet lokale do të përsërisë të njëjtën skemë, pa më të voglën breje të ndërgjegjes. Progresraporti vijon më tej me luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke sjellë në vëmendje aferën e inceneratorëve, e ngritur nga ky grup parlamentar, për të cilën pronarët, administratorët, drejtuesit e 3 kompanive janë sot ose nën pranga, ose të arratisur dhe i gjithë zinxhiri administrativ i Ministrisë së Mjedisit, duke përfshirë ish-ministrin tuaj, Lefter Koka, ish-deputetin Alqi Bllako, është në pranga.

Arrestimet e fundit i kryen dje dhe ato tregojnë fare mirë se kjo aferë nuk është gjë tjetër veçse një bashkëpunim i 3 njerëzve me politikanët e nivelit të lartë të qeverisë. Puna e komisionit hetimor për inceneratorët, 11 kallëzimet penale të bëra nga këta deputetë, “të shiturit”, ka treguar dhe ka provuar katërçipërisht se në atë aferë janë të përfshirë drejtpërdrejt Kryeministri Edi Rama, kryebashkiakët Veliaj, Subashi, Sejдини, ministrat Ahmetaj, Ballkuku, sekretari i Përgjithshëm i Kryeministrit, Agaçi dhe një rrjet i tërë zyrtarësh të niveleve të ndryshme. Mbetet detyrim i SPAK-ut t’i shkojë deri në fund kësaj afere për të çuar përpara gjykatës këdo që ka abuzuar me besimin e qytetarëve dhe me paratë e tyre. Këtë thotë edhe progersraporti që po citoj: “Rritja e numrit të dënimeve përfundimtare të zyrtarëve të nivelit të lartë mbetet një prioritet i rëndësishëm për ta trajtuar më tej kulturën e mosndëshkimit” (raporti i BEsë, një muaj më parë).

Progresraporti konstaton me shqetësim rënien e Shqipërisë për sa i përket lirisë së medias. Atmosfera e sulmeve verbale, fushatave shpifëse, akteve të frikësimit ndaj gazetarëve”, - shprehet Komisioni European, - ka vazhduar edhe gjatë vitit 2021. Në fakt, vazhdojnë edhe në vitin 2022. Për të kuptuar situatën e lirisë së medias në Shqipëri, mjafton të shohësh konferencat dhe statuset e Kryeministrit të mbushura plot me sharje, ofendime, përbaltje, me gjuhën e urrejtjes ndaj medieve dhe gazetarëve. Për Edi Ramën, për qeverinë dhe për këtë maxhorancë liria e medias funksionon vetëm atëherë kur media zgjedh të heshtë ose të lavdërojë punën e tyre. Amnistia fiskale dhe pasaportat e arta janë dy nisma të tjera të kësaj qeverie, për të cilat Komisioni European është i qartë kristal. Raporti thotë: “Iniciativa që do t’i hapë rrugë krimit të organizuar, evazionit fiskal, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit”. Duhej të mjaftonte vetëm kaq që qeveria të deklaronte publikisht heqjen dorë nga dy çmenduritë të radhës.

Në fakt, raporti nuk përbën ndonjë çudi, se ambasadorët e vendeve të Bashkimit European në Shqipëri e kanë thënë në mënyrë të qartë qëndrimin e tyre kundër këtyre nismave. Një qeveri e përgjegjshme nuk do të kishte pritur që kjo të shkruhej e zeza në të bardhë në raportin vjetor të Komisionit European, që të hiqte dorë. Vijnë te një problematikë tjetër, që është po aq shqetësuese, porti i Durrësit. Dua ta filloj me faktin, siç është pranuar publikisht në mbledhjet e komisioneve parlamentare, se ky projekt është zhvilluar pa garë, pa konkurrencë, duke ia dhënë fillimisht një kompanie, që është e regjistruar në parajsat fiskale, pronarët e së cilës kanë preferuar të fshihen pas 5 kompanive të tjera, pra mëma e të cilave është regjistruar në ishujt Cayman.

Pra, mungesa e garës duhej të mjaftonte për të konstatuar se kjo marrëveshje bie ndesh me nenet 71 dhe 74 të MSA-së, që nuk është gjë tjetër, veçse kushtetuta e marrëdhënies së Shqipërisë me Brukselin dhe me Bashkimin European, pra po flasim për progresraportin. Ndërkohë, sot parlamenti e shqyrton

këtë projektligj me procedurë të përshpejtuar, rrufe, natën, pa transparencë dhe me një disbalancë të madhe mes të drejtave që përfiton i huaji dhe humbjeve kolosale që shqiptarët kanë në pasurinë e tyre. Për portin e Durrësit do të diskutojmë kur t'i vijë radha, por nuk mund të rri pa thënë se vazhdoj të mos i gjej një përgjigje pyetjes se si qeveria shqiptare ka zgjedhur t'i japë një kompanie, jo 630 milionë, sa kam thënë këto ditë, por, sipas pohimeve të përfaqësuesve të qeverisë, 730 milionë euro pasuri, dhe shteti shqiptar ka të drejtën për të marrë mbrapsht vetëm shumën mizerabël prej 280 milionë eurosh! Vazhdoj të mos e kuptoj se si ka pranuar qeveria shqiptare një projekt me vlerë investimi të pretenduar 2,1 miliardë euro, kur investitori privat deklaroi se ai vetë merr përsipër të gjejë vetëm 160 milionë, 80 pretendon se i ka, ndërsa 80 do t'i marrë kredi, ndërkohë 1 miliardë e 940 milionë euro nuk dihet nga do të vijë.

Sa më shumë mendoj dhe sa më shumë mendojnë shqiptarët për këto pyetje, ka vetëm një përgjigje: korrupsioni, krimi i organizuar, oligarkia. Këto janë 3 burimet, të cilat do të mbushin gropën e zezë të 1 miliardë e 940 milionë eurove. Pas aferës së inceneratorëve nuk ma kishte marrë mendja që kjo qeveri do të gjente guximin e marrë që të ripërsëriste edhe një aferë tjetër 10-fish më të madhe, ndërkohë që çdo ditë, ndoshta me vonesë, pjesë të qeveritarëve dhe të administratorëve thjesht dhe vetëm shohin prangat në duart e tyre. Pra, ka kaq shumë arsye për të qenë kundër çdo gjëje që bën kjo qeveri. "E duam Shqipërinë si e gjithë Europa", është gjeneza e Partisë Demokratike; është orientimi euroatlantik dhe integrimi europian; kjo është busulla e orientuese e familjes sonë politike, ndaj, si të tillë, rikonfirmojmë, ashtu siç kemi bërë kurdoherë, ndryshe nga qeveritarët e sotëm që mbanin peng proceset e integritit (i mbani mend alibitë që ngrinin në vitin 2009 apo në vitin 2013), se ne do të gjejmë gatishmërinë për shqiptarët, që çdo gjë, e cila i shërben integritit europian dhe që u shërben atyre, të ketë mbështetjen tonë pa më të voglin diskutim, pa më të voglin kompleks.

Po, ajo që është e mirë për shqiptarët, është e mirë për Partinë Demokratike dhe kësaj do t'i qëndrojmë deri në fund. Ne jemi të bindur se rruga e vetme e Shqipërisë është integrimi europian, rruga e vetme e shqiptarëve është Perëndimi. Vetëm një Shqipëri anëtare dhe e integruar në familjen e madhe do të sjellë zhvillim; do të sjellë shtetin e të drejtës; do të sjellë demokracinë dhe do të sjellë ekonomi për shqiptarët. E dimë shumë mirë se negociatat që u hapën, nuk u hapën se kjo qeveri kishte plotësuar kushtet, kishte treguar zellin më të madh për të plotësuar të gjitha rekomandimet e Bashkimit Europian apo kushtet e Bundestagut, dhe për këtë jemi shumë të bindur. Por, është ndihma e Bashkimit Europian për të na mbajtur në familjen europiane dhe për të mos na lënë, siç na la dikur historia, përtej gardhit të Perëndimit. Ne duhet ta vlerësojmë këtë.

Ky vend ka nevojë për ndihmë; demokracia ka nevojë për ndihmë; ekonomia ka nevojë për ndihmë. Ky vend ka nevojë për miq dhe miqtë i kemi në Perëndim. Ne do ta vazhdojmë angazhimin tonë të sinqertë dhe serioz në Komisionin parlamentar për Integrimin Europian dhe në Këshillin Kombëtar të Integrit, të cilët udhëhiqen nga ne, me shpresën e vakët se qeveria do të reflektojë ndaj thirrjes së përsëritur të Komisionit Europian për gjithëpërfshirje pozitive-opozitive në procesin e integrit. Dua ta bëj të qartë edhe njëherë qëndrimin tonë, të kësaj pjese të grupit parlamentar, atë që thashë pak më parë, se çfarë do lloj iniciative ligjore, institucionale për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian për të drejtuar velat e këtij vendi, të ngelur mes të dallgëve të një stuhie 32-vjeçare që e sjell vërdallë, do të ketë mbështetjen tonë.

Ky është orientimi ynë ideologjik, historik, patriotik dhe do t'i qëndrojmë deri në fund, pa mëdyshjen më të vogël. Sirenat, si në rastin e Odisesë, kur kalonte mes Shilës dhe Karibdës, do të vazhdojmë të bëjmë të njëjtën gjë. Anija jonë e vogël, modeste ndoshta, por me zemër dhe guxim të madh, do të vazhdojë drejt, pa rënë në kurthin dhe pa rënë në komplekset e këtyre 30 vjetëve të vjetëve, që duhet të marrin fund. Kjo është kërkesa dhe interesi i shqiptarëve sot. Këtë ua kemi detyrim. Pra, kjo ishte ajo kërkesë, që kam kërkuar para një muaji, dhe do të jetë gjithmonë, sa herë që do të kemi një progresraport nga Bashkimi Europian. Këtë e bëjmë për shqiptarët. E kam shumë të qartë: koka e ulur e maxhorancës, mungesa e qeverisë dhe interesi për afera korruptive do të vazhdojnë, se ata nuk e kanë fare në refene atë që Europa kërkon nga shqiptarët. Pra, na takon neve ta bëjmë, e kemi detyrim ndaj shqiptarëve dhe ndaj Perëndimit, sepse i kemi miq, i kemi aleat dhe do të qëndrojmë deri në fund. Faleminderit!